

Republika e Shqiperise

Tirane, me 21/07/2017

Statuti i një Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar

“LeadGen” Sh.p.k

Në këtë statut

- “Ligi” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më Date 21/07/2017, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin
“LeadGen” Sh.p.k

- Z. Apostol Avduli , I datelindjes 22/02/1960 lindur në Delvinë, Sarandë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, Rruga ismail Qemali, Yzberisht, nr 13, me zotesi te plota juridike per te vepruar dhe mbajtes I dokumentit identifikues 027859594 me numer personal **G00222086T**

Neni 2:
Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Sherbime promovimi, marketingu, ndermjetesimi dhe konsulence tregtare te shoqërisë. Realizim dhe oferta e sherbimeve ne sektorin e marketingut. Studime tregu, plane biznesi, statistika. Konsulenc financiare dhe juridike. Çdo veprim tregtar, industrial dhe finanziar mobiliar dhe imobiliar instrumental në zbatimin e objektit të shoqërisë me perjashtim te aktivitetave qe nuk lejohen nga ligji.

Neni 3:

Faqe 1



Kohëzgjatja, selia

- 1) Kohezgjatja e shoqerise “ **LeadGen** ” Sh.p.k do te jete per nje periudhe te pa përcaktuar.
- 2) Selia e shoqerise do te jete, Njësia Bashkiake nr. 7, Rruga e Kavajës, ish Parku i Autobuzave, Condor Center, kati 2, Tiranë, Shqipëri.
- 3) Kontaktet e shoqërisë për qëllime komunikimi është si vijon:

Tel : **0698701526**

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar I shoqerise eshte me nje vlere prej 100.000 lek, pjesmarrja e themeluesve ne kapital eshte ne perputhje me kontributin e tyre te me poshtme:

- **Z. Apostol Avduli**, është zotërues i 100% të kapitalit me vlerë 100.000 (njëqind mijë) lekë, e barabartë me 1 kuotë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërise mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Faqe 2

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;



i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

Faqe 4



- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërbllimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

- 1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

- (1)Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator shoqërisë :

- Z. **Apostol Avduli**, I datelindjes 22/02/1960 lindur në Delvinë, Sarandë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, Rruga ismail Qemali, Yzberisht, nr 13, me zotesi te plota juridike per te vepruar dhe mbajtes I dokumentit identifikues 027859594 me numer personal **G00222086T**



Neni 14

Kopetencat e Administrator-it(ve)

Administrator-i(ët) ka/në të drejtë e detyrohe-t/n të:

- a) kryej-ë/në të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoj-ë/në shoqërinë tregtare;
- c) kujdese-t/n për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatis-ë/in dhe nënshkruaj-ë/në bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijoj-ë/në një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryej-ë/në regjistrimet dhe dërgoj-ë/në të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportoj-ë/në përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryej-ë/në detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administrator-i(ët) është/janë të detyruar të thërras-ë/in Asamblenë e Përgjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Përgjegjësitë e Administrator-it(ve)

Faqe 6



Administrator-i(ët) është/janë përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administrator-i(ët) detyrohet:

a) të kryej-ë(në) detyrat e tij/tyre të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;

b) të ushtroj-ë(në) kompetencat që i/u njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësoj-ë/në me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandaloj-ë/në dhe mënjanoj-ë/në rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtroj-ë/në detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administrator-i/ët, gjatë kryerjes së detyrave të tij/tyre, përgjigje-t/n ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për tëvërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit, Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpérndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.



Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV
Viti finanziar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka për detyre që të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesse e dorëzoje në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V
Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;



ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqeri ne likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19
Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20
Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me ketë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21


Mosmarrëveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund te lindë midis Shoqërise dhe të tretëve, do të jete kompetente çdo gjykatë Shqiptare e shkallës së parë .

Neni 22

Regjistrimi i Shoqerise Prane QKR-se

Caktohet Administratori i Shoqerise Z. Apostol Avduli për ndjekjen e procedurave të regjistrimit të shoqerisë pranë QKB-së.



ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Apostol Avduli

Apostol e Avdulci
